



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 02.10.2019, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Jurgis Çyrbja, Spartak Braho, Adriatik Alimadhi, Aurora Mara, Elda Hoti, Elena Xhina, Nikolin Staka dhe Ediola Braha

Mungojnë:

Korab Lita, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Damian Gjiknuri, Alban Zeneli, Andi Përmeti dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Etjen Xhafaj – Zëvendesministër për Europën dhe Punët e Jashtme
Shpresa Shahaj – Drejtoreshë e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane
Arlinda Gjata - Specialiste në Drejtorinë e të Drejtës Ndërkombëtare dhe Evropiane
Ilir Bejko - Drejtor i Vlerësimit të Legjislacionit në Ministrinë e Drejtesisë
Ismail Shehu - Drejtor në Drejtorinë e Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore në Ministrinë e Mbrojtjes
Elton Hodaj - jurist i AKSHE-së në Ministrinë e Mbrojtjes
Renata Balliu - shefe sektori në Drejtorinë Juridike në Ministrinë e Brendshme
Enkela Prifti - drejtor i komanduar juridik në Policinë e Shtetit
Edlira Llango - drejtoreshë e Programimit, Standartizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Bujqësisë

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve për ditën e sotme.

Kuorumi është i plotë për të vazhduar me një çështje në rendin e ditës, por përpara se të fillojmë me shqyrtimin e këtij projektligji, më lejoni që, në emrin tim, por edhe tuajin, t'i urojmë zonjës Elena Xhina gëzuar ditëlindjen. Festofshim sa më shumë ditëlindje në Komisionin e Ligjeve, Elena dhe ditë të mbarë!

Çështja që kemi sot është projektligji “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikës e Shqipërisë”. Komisioni i Ligjeve është komision për dhënie mendimi dhe relator është kolegu Edmond Leka.

Kemi ftuar 5 ministri për të qenë të pranishme në diskutimin e këtij projektligji. Nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme kemi zëvendësministrin, zotin Etjen Xhafaj dhe stafin e kësaj ministrie që e shoqëron, të cilët do të prezantohen kur të marrin fjalën.

Mirë se erdhët, zoti Xhafaj!

Nga Ministria e Drejtësisë kemi zotin Ilir Bejko, drejtor i Legjislacionit, nga Ministria e Mbrojtjes zotin Ismail Shehu, drejtor i Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Akteve Rregullatore, si dhe juristin e kësaj ministrie, nga Ministria e Brendshme kemi zonjën Renata Balliu bashkë me drejtoreshën juridike, zonjën Enkela Prifti. Kemi të ftuar edhe nga Ministria e Bujqësisë, por nuk kanë ardhur edhe pse e kanë konfirmuar pjesëmarrjen.

Mirë se keni ardhur përfaqësues të ministrive!

Fjalën do t'ia kaloj zotit Xhafaj, për të bërë një prezantim të projektligjit, e më pas zotit Leka.

Fjala për ju, zoti Xhafaj.

Etjen Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë,

Projektligji që sjellim sot “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” ka si qëllim vendosjen dhe zbatimin e masave shtrënguese ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së paqes dhe sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, të sundimit të ligjit, të të drejtave të njeriut, si dhe arritjes së objektivave të tjera të sigurisë së përbashkët në përputhje me rezolutat përkatëse të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, akteve të organizatave të tjera ndërkombëtare, apo marrëveshjeve ndërkombëtare, ku Shqipëria është palë, siç është dhe BE-ja.

Masat shtrënguese ndërkombëtare janë një instrument tejet kompleks i politikës së jashtme dhe, për vendosjen e tyre, është i detyrueshëm respektimi i parimit të sundimit të ligjit, mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe synohet që aktorët politikë të rishohin kursin në lidhje me respektimin e këtyre vlerave.

Kjo iniciativë është në përputhje me detyrimin që Republika e Shqipërisë ka, si vend anëtar i Kombeve të Bashkuara, për zbatimin e rezolutave të OKB-së, që dalin në zbatim të kreut 7 të Kartës së Kombeve të Bashkuara dhe të rekomandimeve të *task force* për veprim financiar, që kanë rishikuar standardet ndërkombëtare sa i përket luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit. Konkretisht është rekomandimi nr. 6 “Për sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e tij”, si dhe rekomandimi nr. 7 “Për sanksionet specifike financiare dhe financimin me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë”. Gjithashtu në kuadër të gjetjeve të Komitetit të Ekspertëve të KE-së *Moneyval*, ku ne jemi anëtarë që nga vitit 2011 dhe si vend që aspiron anëtarësimin në BE, miratimi i një projektligji të tillë është një domosdoshmëri për të pasur përputhje me aktet dhe vendimmarrjet mbi masat shtrënguese nga KE-ja.

Në vitin 2011 kemi pasur një histori ku jemi vlerësuar negativisht nga *Moneyval*-i për sa i përket përputhshmërisë me implementimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, e cila në vitin 2015, u revokua dhe ka lënë disa detyra edhe në vitin 2017 dhe 2018, ndërkohë që jemi në raundin e 5-të të vlerësimit nga *Moneyval*. Ligji “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë” është një nga kërkesat e tyre kryesore. Gjithashtu doja të theksoja se në kuadër të projektligjit, që kemi sjellë sot, aktualisht ne e kemi një kuadër legjislativ të brendshëm, i cili bazohet në ligjin nr. 157/2013 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, i ndryshuar”, që zbatohet për masat shtrënguese ndërkombëtare të ndërmarra në kuadër të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, natyra e të cilave lidhet me terrorizmin, apo financimin e tij.

Ajo që kemi bërë në vijim të sugjerimeve të *Moneyval*-it ka qenë përshpejtimi i të gjithë procesit ndërinstitutional për ndjekjen e këtyre masave, duke kaluar në dokumente të menjëhershme në momentin që vjen informacioni qoftë nga OKB-ja, qoftë nga partnerë të tjerë ndërkombëtarë, të cilët luajnë një rol primar në luftën ndaj terrorizmit dhe parandalimit të pastrimit të parave. Kjo është një nga detyrat e sugjeruara nga *Moneyval* dhe që është kryer tanimë.

Detyra e dytë e domosdoshme është projektligji “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Aktualisht ka një boshllëk ligjor lidhur me masat shtrënguese, që nuk lidhen me terrorizmin dhe financimin e tij, por kanë të bëjnë me financimin e armëve të shkatërrimit në masë dhe lidhen me zbatimin e drejtpërdrejtë të rezolutave të dala në zbatim

të kapitullit të 7-të të Kartës së Kombeve të Bashkuara për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare për shtetet anëtare të saj (neni 24 i kreut 5 të kartës, i cili përcakton se për të siguruar një veprimtari të shpejtë dhe efektive nga Kombet e Bashkuara, anëtarët e tij diskutojnë në Këshillin e Sigurimit përgjegjësinë kryesore për ruajtjen e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe bien dakord me kryerjen e detyrimeve të tyre, që rrjedhin nga kjo përgjegjësi).

Rrjedhimisht Këshilli i Sigurimit vepron në emër të vendeve anëtare dhe ato i zbatojnë këto masa. Gjithashtu, doja të thosha se në shqyrtimin dhe në përgatitjen e këtij projektligje janë përfshirë të gjitha institucionet publike të pranishme në sallë, por duke shtuar edhe disa nga agjencitë kryesore të sigurisë në Republikën e Shqipërisë, si SHIK-un, Autoritetin për Mbikëqyrjen dhe Parandalimin e Pastrimit të Parave, si dhe një sërë institucionesh të tjera. Iniciativa ligjore është në përputhje me objektivat e qeverisë dhe e mbështetur në objektivat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Integritetit European 2019-2021, kapitulli 24 “Drejtësia, liria dhe siguria”, si dhe është pjesë e programit të përgjithshëm analitik të projekteve të miratuara për vitin 2019 me VKM nr. 37 datë 24.01.2018, gjithashtu dhe në përputhje të plotë me nenet 5, 78, pika 1, dhe 83 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Grupi i punës është i përbërë nga Ministria e Brendshme, Avokatura e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Drejtoria e Parandalimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara, Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, Banka e Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe SHISH-i.

Kostot, të cilat i janë ngarkuar buxhetit të shtetit janë minimale dhe kanë të bëjnë vetëm me strukturën implementuese brenda Ministrisë për Europës dhe Punët e Jashtme. Sa i përket mekanizmave të zbatimit të masave parandaluese, do të kemi një strukturë në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme, e cila do të marrë informacion të menjëhershëm dhe do ta shpërndajë, si dhe do të administrojë një *server* të veçantë, i cili do të merret me monitorimin e zbatimit të këtyre masave parandaluese nga partnerët. Do të kemi ngritjen e një komiteti shtetëror për masat parandaluese, ku do të përfshihen një sërë institucionesh dhe kjo bëhet në funksion të zbatimit të masave ndërkombëtare, që vijnë si pasojë e angazhimit shqiptar në konventa të ndryshme që kemi nënshkruar, apo bashkëpunimit me organizatat shumëpalëshe, por ka edhe një mekanizëm brenda së cilit mund të bëhen këto masa edhe nëpërmjet mekanizmave të brendshëm apo marrëveshjeve dypalëshe. Të gjitha këto do t'i nënshtrohen një kontrolli të qenësishëm.

Projektligji rregullon gjithashtu procedurën e vendosjes, zbatimit, ndryshimit dhe shfuqizimit të masave shtrënguese ndërkombëtare dhe administrimin e të dhënave në respekt të plotë të të gjitha ligjeve aktuale.

Duke qenë se është një nga ato masa të domosdoshme, do t'ju ftoja ta vonit të gjithë!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Fjalën po ia kaloj zotit Leka, për të bërë një përmbledhje të relatimit të projektligjit në përputhje me bazën kushtetuese dhe ligjore.

Fjala për ju, zoti Leka.

Edmond Leka - Faleminderit, zoti kryetar!

Informimi që bëri zoti Xhafaj ishte shterues! Qëllimi i projektligjit është vendosja dhe zbatimi i masave shtrënguese ndërkombëtare në funksion të ruajtjes së paqes dhe të sigurisë, parandalimit të konflikteve ndërkombëtare, mbështetjes dhe forcimit të demokracisë, të sundimit të ligjit, të të drejtave të njeriut, si dhe arritjes së objektivave të tjera të sigurisë së përbashkët, përveç përmbushjes së qëllimit për ruajtjen e paqes dhe sigurisë. Ky projektligj ka si detyrim edhe përmbushjen e detyrimeve që ka vendi ynë si anëtar i Kombeve të Bashkuara për zbatimin e rezolutave të OKB-së, që dalin në zbatim të kreut 7, veprime në rast të rrezikimit të paqes dhe kryerjes së një akti agresioni, të Kartës së Kombeve të Bashkuara, si dhe rekomandimet e *task force* për veprim financiar, që ka riparë standardet ndërkombëtare sa i përket luftës kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

Konkretisht përmendi rekomandimin 6 “Për sanksionet specifike financiare të lidhura me terrorizmin dhe financimin e tij”, si dhe rekomandimi nr. 7 “Për sanksionet specifike financiare dhe financimin me përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë”. Në këtë frymë vijnë edhe rekomandimet e Komitetit *Moneyval*, i cili është organizëm monitorues i KE-së nën varësinë e komitetit të Këshillit të Ministrave të KE-së, apo detyrimi për zbatimin e masave shtrënguese të BE-së në vijim të politikës së përbashkët të jashtme dhe sigurisë, në kuadër kjo edhe të aspiratës që kemi si vend për anëtarësimin në BE. Në zbatimin e këtij projektligji ngarkohen institucione si Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe të gjitha strukturat e varësisë, Ministria e Drejtësisë dhe strukturat e varësisë, Ministria e Mbrojtjes dhe strukturat e saj, Ministria e Brendshme, Ministria e Bujqësisë, Ministria përgjegjëse për çështjet e infrastrukturës dhe strukturat e varësisë, Banka Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, Prokuroria e Përgjithshme dhe Shërbimi Informativ.

Kryetar, ne nuk jemi komision përgjegjës, por kemi disa sugjerime në nene të caktuara. Kur të vijë diskutimi nën për nen, kolegët i kanë përpara të gjitha propozimet që kemi bërë dhe mund t'i shohin. Disa sugjerime janë të gjata. Disa ndryshime që kemi propozuar kanë të bëjnë vetëm me teknikën legislative dhe do t'ia kalojmë komisionit përgjegjës për miratim.

Ju faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

A ka pyetje nga kolegët? Nuk ka. A ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet në parim projektligji “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

Një projektligj i punuar nga 5 ministri dhe 15 agjenci, që pothuajse ka një tabelë përputhshmërie me standardet ndërkombëtare, nuk besoj se duhet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen të këtij projektligji. Për më tepër, komisioni ynë është komision për dhënie mendimi dhe i kërkohet të shohë përputhshmërinë e projektligjit me Kushtetutën dhe kuadrin ligjor në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Natyrisht, vlejné sugjerimet që ne, si komision, do të bëjmë për Komisionin e Sigurisë Kombëtare, që është edhe komisioni përgjegjës.

Kështu që, zoti Leka, do t’ju kërkoja që në shqyrtimin dhe miratimi nen për nen ta merrni fjalën aty ku keni sugjerime. Nuk besoj se është nevoja t’i lexoni sugjerimet që bëni, sepse shoh që janë komente të gjata, por përfaqësuesit e ministrisë, pra zoti Xhafaj e të tjerë, duhet të shprehen nëse janë apo jo dakord me sugjerimet që i bëjmë komisionit përgjegjës.

Kalojmë te neni 1. Neni 1 është qëllimi i projektligjit. Ky projektligj fillon me kreun I, “Të përgjithshme”. Neni 1, “Qëllimi”.

A jeni dakord me nenin 1? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 1.

Kalojmë te neni 2, “Objekti”.

A ka ndonjë sugjerim për objektin, zoti Leka?

Edmond Leka – Po, zoti kryetar, ka një sugjerim te pika 1 e nenit 2. Kolegët e kanë sugjerimin përpara, sepse e thatë edhe ju...

Ulsi Manja – Është çështje e teknikës legjislative.

Edmond Leka – Po, është çështje e teknikës legjislative. Kolegët e kanë përpara sugjerimin.

Ulsi Manja – A është dakord ministria?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kush është pro nenit 2? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 2.

Kalojmë te neni 3, “Fusha e zbatimit”.

Edmond Leka – Nuk kemi sugjerime.

Ulsi Manja – Kush është dakord? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 3.

Kalojmë te neni 4, “Përkufizime”. Edhe këtu ka...

Edmond Leka – Te pika 4 e nenit 4 ka një sugjerim. Përfaqësuesit e ministrive e kanë përpara sugjerimin. Po kështu, edhe për pikën 10 të nenit 4 ka një sugjerim.

Ulsi Manja – Pra, janë sugjerime të teknikës legislative, që nuk e ndryshojnë thelbin e nenit.

A është dakord ministria? Dakord.

Kush është pro nenit 4? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Alimadhi.

(Deputeti Adriatik Alimadhi flet pa mikrofon.)

Adriatik Alimadhi – ...“në sytë e ligjit”...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Ju lutem, kolegë! Çështjet e teknikës legislative dhe të përputhshmërisë me gjuhën e ligjit, kur të zbardhet raporti i Komisionit të Ligjeve për komisionin përgjegjës, relatori dhe këshilltari i komisionit t’i mbajnë në konsideratë, që të përputhen me gjuhën e ligjit.

Kalojmë te neni 5, “Llojet e masave shtrënguese”.

Po, zoti Leka.

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është pro nenit 5? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 5.

Kalojmë te neni 6, që i përket kreut II, “Vendosja, zbatimi, ndryshimi dhe shfuqizimi i masave shtrënguese”. Neni 6 fillon me zbatimin, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ndizeni mikrofonin!

Edmond Leka – Kryetar, ka një sugjerim te pika 1 e nenit 6. Këto sugjerime janë të teknikës legislative. Të gjitha sugjerimet i keni përpara.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 6 ? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 6.

Kalojmë te neni 7, “Zbatimi, ndryshimi dhe shfuqizimi i masave shtrënguese të Këshillit të Sigurimit”. Ka një sugjerim për këtë nen.

Edmond Leka – Te neni 7 është riformulimi i pikës 5. Nxjerrja e akteve nënligjore ka të bëjë me shërbimin e zbatimit të ligjit dhe duhet të përcaktohet si detyrë e organeve përgjegjëse për të propozuar aktet nënligjore në kuadër të zbatimit objektiv të ligjit.

Ulsi Manja – Ka të bëjë me propozimin për nxjerrjen e akteve nënligjore.

Kush është dakord me nenin 7? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 7.

Kalojmë te neni 8, “Bllokimi i përkohshëm”. Nuk ka sugjerime për këtë nen.

A jeni dakord, zoti Leka?

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 8.

Kalojmë te neni 9, “Masat shtrënguese ndërkombëtare me karakter të brendshëm”.

Edmond Leka – Te neni 9, kryetar, kemi një sugjerim në pikën 2.

Ulsi Manja - Kush është dakord me nenin 9, me sugjerimin e bërë?

Po, zoti Braho. Ju lutem, shtypeni mikrofonin!

Spartak Braho – Pika 1: “Këshilli i Ministrave miraton vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare me karakter të brendshëm”. Në çfarë aktesh?

Çfarë përdor Këshilli i Ministrave në këtë rast?

Ulsi Manja – Me çfarë akti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jepini një përgjigje zotit Braho.

Shpresa Shahaj – Faleminderit për pyetjen! Akti i vetëm me të cilin del Këshilli i Ministrave në këto raste është vendimi. Prandaj nuk është cituar në...

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Braho!

E hedhim në votim nenin 9.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 9.

Kalojmë te neni 10, “Komiteti i Masave Shtrënguese Ndërkombëtare”.

Edmond Leka – Për nenin 10 kemi shumë sugjerime, që mund t’i shohin përfaqësuesit e qeverisë dhe të bien dakord.

Ulsi Manja – Te neni 10 janë ndryshuar vendet? Kush e ka...?

Ju lutem, shihini sugjerimet e nenit 10! Ta hedhim në votim në fund, para se ta kaloj...

Përfaqësuese e ministrisë, të lutem, shikoje nenin 10. Para votimit në tërësi t'i rikthehemi votimit të nenit 10.

Kalojmë te neni...

(Diskutime pa mikrofon)

Ju lutem, shtypeni mikrofonin! Çfarë presupozojnë sugjerimet që i keni bërë relatorit për nenin 10?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord.

Neni 10 do të hidhet në votim duke i lënë detyrë relatorit, këshilltarit dhe përfaqësuesit të ministrisë të bëjnë riformulimin e duhur. Më tepër këto janë riformulime të karakterit të teknikës legislative për të qartësuar dispozitën dhe nuk e prekin thelbin e saj. Me sa shoh, është ndryshuar renditja e germave.

Dua të shtoj diçka për shërbimet e komisionit: këto sugjerime që bëni për nene të caktuara duhet t'ua kishit përcjellë ministrive të linjës para se të vinin këtu. Dakord? Nisur nga kjo, nenet për të cilat përfaqësuesit e ministrive i lexojnë sugjerimet këtu, do të kalojnë sipas variantit të qeverisë.

Kush është pro nenit 10? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 10.

Kalojmë te neni 11, "Organet përgjegjëse". Edhe këtu ka disa sugjerime, të cilat do të shihen në momentin e zbardhjes së raportit për Komisionin e Sigurisë Kombëtare.

Kush është dakord me nenin 11? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 11.

Kalojmë te neni 12, "Bllokimi i aseteve dhe fondeve".

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 12.

Kalojmë te neni 13, "Lejimi i përdorimit të aseteve të bllokuara". Nuk ka sugjerime këtu.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 13.

Kalojmë te neni 14, "Përpunimi i të dhënave". Edhe këtu nuk ka sugjerime nga relatori.

Kush është pro?

Edmond Leka – Jam dakord.

Ulsi Manja - Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 14.

Kalojmë te neni 15, “Regjistri i të dhënave”. Ka një sugjerim për këtë nen. Sugjerohet që regjistri i të dhënave të përfshihet te neni 4 i përkufizimeve, pra të shtohet te neni 4 si përkufizim. Ky sugjerim qëndron.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 15.

Kalojmë te neni 16, “E drejta për informim”. Nuk ka sugjerime nga relatori, zoti Leka.

Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 16.

Kalojmë te neni 17, “Publikimi i masave shtrënguese ndërkombëtare”. As këtu nuk ka sugjerime nga relatori.

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja - Kush është pro? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 17.

Kalojmë te neni 18, “E drejta për ankim”. Nuk ka sugjerime për këtë nen.

Kush është dakord me nenin 18? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 18.

Kalojmë te neni 19, “Masat ndëshkuese”. Këtu ka një sugjerim.

Po, zoti Leka.

Edmond Leka – Te neni 19 ka një sugjerim, që ka të bëjë me masat shtrënguese. Subjektet, pasi i kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimimit administrativ, mund të paraqiten në Gjykatën Administrative për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.

Ulsi Manja – A jeni dakord me sugjerimin?

Ka një sugjerim, pra riformulimi i pikës 6 të nenit 19 sipas asaj që relatoi zoti Leka.

Kush është pro nenit 19?

Edmond Leka – Dakord.

Ulsi Manja – Po, zoti Alimadhi.

Adriatik Alimadhi – Te fjalja “Subjektet, pasi kanë shteruar të gjitha mjetet e ankimimit...”, termin “shteruar” duhet ta hiqni, sepse duhet të flasim prerë në gjuhën juridike dhe ligjore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Alimadhi!

Kush është dakord me nenin 19? Kundër nuk ka. Abstenim nuk ka.

Miratohet neni 19.

Kalojmë te neni 20, “Kërkesa për kompensim”. Nuk ka sugjerime këtu.

Po, zoti Braho.

Spartak Braho – Do të doja një koment nga përfaqësuesit për këtë nen. Këtu është një gjë shumë e madhe. Ti më heq të drejtën për të kërkuar zhdëmtim në një rast kur unë dëmtohem padrejtësisht.

Ulsi Manja – Në nenin 20 “Kërkesa për kompensim”, thuhet: “Nuk mund të paraqitet një kërkesë për kompensim kundër Republikës së Shqipërisë apo organit përgjegjës për zbatimin e masave të parashikuara në këtë ligj për dëmin e shkaktuar nga vendosja e masave shtrënguese ndërkombëtare”. Ka përgjigje për këtë?

Ju lutem, ndizni dhe afroni mikrofonin!

Shkurt, ju lutem!

Shpresa Shahaj – Bëhet fjalë për masat e vendosura nga Këshilli i Sigurimit të OKB-së, që nuk janë masa të vendosura nga Republika e Shqipërisë. Në këto raste Republika e Shqipërisë vetëm i zbaton, kështu që subjektet nuk mund të padisin Republikën e Shqipërisë për një masë të vendosur nga Këshilli i Sigurimeve. Ka mekanizma të tjerë ndërkombëtarë ku subjektet mund të drejtohen.

Ulsi Manja – Faleminderit për sqarimin, i cili ishte i nevojshëm!

Po, zonja Hysi.

Vasilika Hysi – I rikthehem edhe një herë shqetësimit të drejtë të kolegut Braho.

Diku në ligj ju thoni se nuk mund të kërkohej kompensim, përveç rasteve kur dëmi është shkaktuar nga autoritete tona të brendshme.

Mënyra se si është shkruar neni 20 “Kërkesa për kompensim”, i ka vënë të gjitha së bashku, si në rastet kur dëmi është shkaktuar nga vendosja e masave shtrënguese ndërkombëtare, ashtu edhe kur gabimet janë bërë nga autoritetet e brendshme.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në titull.

Sepse thuhet: “Nuk mund të paraqitet një kërkesë për kompensim kundër Republikës së Shqipërisë, organit për zbatimin e masave të parashikuara në këtë ligj për dëmet e shkaktuara nga vendosja e masave shtrënguese”. Nëse gabimet i kanë bërë autoritete tona, në një nga nenet që sapo miratuam, thuhet: “Me përjashtim të rasteve, lejohet kompensimi kur dëmi është shkaktuar nga autoritetet tona”. Sqaroj: te masat shtrënguese me karakter të brendshëm. Kjo duhet parë me kujdes ose duhet riformuluar titulli.

Ulsi Manja – Përfaqësuesja e ministrisë.

Shpresa Shahaj – Kur themi “Për gabimet e shtetit shqiptar” bëhet fjalë se nëse nga misioni i OKB-së na ka ardhur një njoftim për t’i vendosur sanksion një subjekti, ne, gjatë transpozimit të kësaj dispozite mund të gabojmë emrin apo të dhëna të tjera. Në këto raste,

subjektit, të cilin i kemi vendosur sanksion gabimisht, duhet t'i anulohet sanksioni e vendosur nga Republika e Shqipërisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër që do të marrë dëmshpërblim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Vasilika Hysi – Në pikën 4 të nenin 18 “E drejta për ankim” thuhet: “Për dëmet e shkaktuara në zbatim të rezolutave të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara ose vendimeve të Organizatave Ndërkombëtare nuk mund të kërkohej dëmshpërblim nga shteti shqiptar, përveç rastit kur dëmi i shkaktuar me qëllim apo me faj nga ky i fundit, që do të thotë se në nenin 20 kërkesa për kompensim nuk lejohet në rastet kur është vendosur një masë dhe nuk është bërë ndonjë faj ose gabim nga shteti shqiptar. Pra, neni 18, pika 4, me nenin 20, krijon kakofoni.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Në pikën 4 të nenit 18, ku flitet për raportin e shtetit shqiptar me Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, thuhet: “Shteti shqiptar nuk mund të kërkojë dëmshpërblim, përveç rasteve kur dëmi shkaktohet me qëllim ose me faj nga ky i fundit”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër.

Nuk ka lidhje me nenin 20 për kërkesën për kompensim. Në nenin 20 thotë: “Nuk mund të paraqitet një kërkesë për kompensim kundër Republikës së Shqipërisë apo organit përgjegjës për zbatimin e masave të parashikuara në këtë ligj për dëmin e shkaktuar nga vendosja e masave shtrënguese ndërkombëtare”, që i vendos Këshilli i Sigurimit Kombëtar.

Vasilika Hysi – Jo, “ka gabuar me faj qeveria shqiptare”.

Ulsi Manja – Zonja tha: “Kur masa vendoset në objekt, pra emri, mbiemri apo subjekti, patjetër që ka të drejtën për dëmshpërblim”.

Alket Hyseni – Ka një kakofoni të pastër dhe të mos fshihemi pas gishtit.

Dispozita 20 është fundore, që përjashton dispozitat e mëparshme. Nëse këtu themi se nuk ngrihet, bie dispozita e nenit 18, ndaj duhet ta sqarojmë. Ose këtu duhet të themi “me përjashtim të rasteve të parashikuara në pikën 4 të nenit 18” ose ta sqarojmë te dispozita konkrete. Formulimi është kakofoni.

Ulsi Manja – Më falni, zoti Hyseni!

Po, zoti Xhafaj.

Etjen Xhafaj – Ne do të rimbledhim grupin e punës për të bashkuar këto dy dispozita, që të kemi një masë ezauruese për të gjitha.

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Majna - Zoti Xhafaj, bashkë me relatorin dhe këshilltarët e komisionit mund t'i bashkoni nenet 20 dhe 18 në një të vetëm, por është e rëndësishme të dalë e qartë, sepse në nenin 20 thuhet: "...nga vendosja e masave shtrënguese ndërkombëtare". Qartësoheni në cilat raste ka të drejtë për kompensim dhe në cilat raste nuk ka.

Kush është dakord me sugjerimin që bëhet në nenin 20? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 21. Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 22 "Hyrja në fuqi e ligjit". Kush është pro? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të këtij projektligji. Kush është pro në tërësi me projektligjin? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet edhe në tërësi projektligji "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë".

Të bëhet gati raporti i zbardhur i këtij projektligji, me sugjerimet që u dhanë këtu për Komisionin e Sigurisë Kombëtare dhe t'i përcillet komisionit përgjegjës e më pas seancës plenare për ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Vasilika Hysi – Dua të them diçka për të ardhmen.

Ulsi Manja - Për të ardhmen? Të jemi shëndoshë deri atëherë. Tërmeti na fali këtë radhë, por herën tjetër ...

Faleminderit dhe ditë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA